



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS - SHTIME
Komiteti për Komunitete
Nr.01-06/01-24715/21 datë: 17.09.2021



Npi – 01/258 datë: 22.09.2021

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 53 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040, Si dhe në bazë të nenit 3.8 dhe 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve Npi – 01/114 datë: 26.04.2019. Komiteti për Komunitete për mbledhjen e mbajtur më: 22.09.2021, nxjerr këtë:

E K S T R A K T
P R O C E S V E R B A L

I M B L E D H J E S Ë -IX- TË KOMITETIT PËR KOMUNITETE

E mbajtur më: 22.09.2021 (e mërkurë) në ora 14.00 h. në sallën e vogël të Kuvendit.

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesi i Komitetit: z.Rrahman Kadrija, anëtarët: znj.Fatmire Ferati, znj.Diarta Vishesella, z.Muhamet Ademaj, z.Ruzhdi Brahimi, znj.Xhevahire Ramadani dhe z.Arton Demiri. Në mbledhje përveq këtyre kanë marrë pjesë edhe: Nga Zyra për Komunitete dhe Kthim, shefi i zyrës z.Ibrahim Demiri.

Mbledhjen e hapi Kryesuesi z.Rrahman Kadrija i cili pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi kuorumin e mjaftueshëm për të vazhduar me mbledhjen Komitetit. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

R E N D D I T E

1. Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 30.08.2021,
2. Informatë nga DKA për gjendjen në arsim me theks të rexhistrimi i nxënësve të komunitetit pakicë,
3. Informatë nga ZKKK për aktivitetet mujore,
4. Të ndryshme.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Hapi diskutimin për Rendin e Ditës.

*** Komiteti për Komunitete, unanimitisht aprovoi Rendin e Ditës.**

Pika I

Shqyrtimi i Ekstrakt Procesverbalit nga mbledhja më 30.08.2021

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Dua ta njoftoj Komitetin se Ekstrakt Procesverbali i datës 30.08.2021, nuk është gati, kështu që këtë pikë duhet ta shtyjme për mbledhjen e radhës.

*** Komiteti për Komunitete, unanimitisht vendosi që ta shtyjë këtë pikë për mbledhjen e radhës.**

Pika 2

Informatë nga DKA për gjendjen në arsim me theks të rexhistrimi i nxënësve të komunitetit pakicë

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Hapi diskutimin për këtë pikë.

z.Muhamet Ademaj; Përshëndetje, unë desha vetëm të ju informojë se në shkollën e mesme profesionale në Shtime ende ka vende të lira për regjistrimin e nxënësve. Sa i përket kësaj pike ka qenë e udhës që me ardhë dikush nga DKA-ja dhe me na informuar.

z.Ibrahim Demiri, përgjegjës i ZKKK; Sa i përket komunitetit pakicë kemi 93 nxënës gjithësej në shkolla. 12 prej tyre e kanë kryer klasen e 9-të. Qëllimi ynë është që të mos mbetet asnjë nxënës pa u rexhistruar në shkollën e mesme. Ne i kemi statistikën e sakta sepse në vetë i kemi bërë ato, kështu që kemi 31 nxënës në shkollën e mesme, që të gjithë kanë marrë bursa, ata do ti paisim me tekste shkollore falas.

Pika 3

Informatë nga ZKKK për aktivitetet mujore

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Unë e njoftoi komitetin, meqenëse Ibrahim Demiri kishte një rastë me nipin e tij që e kishin dërguar në spital, ai u largua nga mbledhja, prandaj propozoi që këtë pikë ta shtyejmë.

Pika 4

Të ndryshme

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Hapi diskutimin për këtë pikë .

z.Muhamet Ademaj; Unë dua ti falënderoj të gjithë për bashkëpunimin që kemi pas, po ashtu e falënderoj edhe sekretarinë e kuvendit që ka qenë bashkëpunues.

Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija; Unë e falënderoj shefin e zyrës për bashkëpunim shumë të mirë. Po ashtu e falënderoj edhe sekretarin e kuvendit për punën e palodhëshme. Meqenëse është mbledhje përmbyllëse unë ju dëshiroj suksese të mëtutjeshme.

z.Ruzhdi Brahimi; Përshëndetje, unë kërkoj falje se ndoshta ua kam qarë kryet me fjalimet e mija, por ju falënderoj të gjithëve, e në veqanti Idajet Rexhepin dhe Ibrahim Demirin. Ju uroj punë dhe suksese të mëtejme.

Pasi që diskutime tjera nuk kishte, Kryesuesi, z.Rrahman Kadrija mbledhjen e përfundoi në ora 14.30 h.

Procesmbajtës
Idajet Rexhepi



Kryesuesi i Komitetit
Rrahman Kadrija